



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksion i Përgjithshëm



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201700781/2

Tiranë ___/___/2017

Lënda: *Rekomandojmë marrjen e masave për përmirësimin e shërbimit sociale në Shtëpinë e Fëmijës 3-6 vjeç, Shkodër, me Vendimi të Këshillit të Ministrave Nr. 105 datë 15.02.2017 është "Godinën e Shtëpisë së Fëmijës 16-18 vjeç Shkodër" dhe funksioni për të cilin do të përdoret prona ndryshohet në "Shtëpi familje për fëmijët 16-18 vjeç".*

Drejtuar: **Znj. Merita Xhafaj**
Drejtoreshë e Përgjithshme
Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

Znj. Etleva BISHA
Shërbimi Social Shtetëror
Drejtoreshë e Përgjithshme

Tiranë

Znj. Arlinda Kruja
Drejtoreshë e Shtëpisë së Fëmijës 3-6 vjeç

Shkodër

Për dijeni: **Znj. Voltana Ademi**
Kryetare e Bashkisë Shkodër

Seksioni i Mbrojtjes dhe Promovimit të të Drejtave të Fëmijëve pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, në zbatim të urdhrimit të Avokatit të Popullit nr. 51, datë 03.04.2017, kreu një inspektim të përgjithshëm në Shtëpinë e Fëmijës, 3-6 vjeç më datë 22.06.2017. Avokati i Popullit pasi shqyrtojë informacionin nga monitorimi i realizuar ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrijë konkluzionet përfundimtare.

Objektivat e inspektimit:

- Vlersimi i dokumentacionit, procedurave dhe personelit në zbatim të legjislativës në fuqi.
- Respektimi i të drejtave të të fëmijëve në zbatim të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

Metodologjia

Grupi inspektues i institucionit të Avokatit të Popullit, i përbërë nga një juriste dhe një punonjës social, si metodologji pune ka përdorur:

- Zhvillimin e bisedave paraprake me drejtuesit e këtyre institucioneve, informacion i cili është hedhur në një formular standard për inspektimet e këtyre institucioneve.
- Analiza e akteve ligjore dhe nënligjore që janë në fuqi në fushën e ofrimit të shërbimeve sociale për fëmijët në nevojë.

Në përfundim të inspektimit, grupi monitorues i Institucionit të Avokatit të Popullit ka kryer bisedën përmbyllëse me drejtuesin e institucionit dhe stafin në shërbim të drejtëpërdrejtë me përfituesit, ku u adresuan problematikat e evidentuara gjatë inspektimit ku u lanë edhe rekomandimet përkatëse, të cilat gjenden të detajuar në fund të raportit.

SHTËPIA E FËMIJËS 3-6 vjeç, SHKODËR

Tipologjia: Institucion i përkujdesit social rezidencial nën administrimin e Shërbimit Social Shtetëror

Drejtuesi: Znj.Arlinda Kruja

Adresa: Shkodër

Nr i stafit: 18 punonjës

Nr i përfituesve: 4 përfitues të grupmoshës 3-7 vjeç

Shërbimet që ofrohen në këtë qëndër janë:

- Plotësimi i nevojave bazë ushqim, strehim ,veshmbathje
- Plotësimi i nevojave shëndetsore
- Shërbime psiko-sociale
- Terapi grupi dhe pune okupacionale
- Pjesmarrje në aktivitete kulturore

Kontrolli i performancës administrative dhe organizative

Shtëpia e Fëmijës 3-6 vjeç, Shkodër, është i pa-licensuar nga QKB, në zbatim të ligjit Nr. 10 081 datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ku përcaktohet tipologjia e shërbimit dhe kategoritë përfituese në zbatim të VKM Nr. 538, datë 26.05.2009.

Administrimi dhe funksionimi i këtij institucioni është në zbatim të rregullores me Nr.1571 datë 07.07.2016 “Rregullore e brendëshme e organizimit dhe funksionimit të Shtëpisë së Fëmijës 3-6 vjeç, Shkodër” të dërguar, me shkresën zyrtare Nr. 1571 Prot. datë, 07.07.2016, nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, ku përcaktohet se ky institucion ofron shërbime të përkujdesit social për fëmijë të grupmoshës 3-6 vjeç.

Gjatë inspektimit të realizuar në këtë institucion nuk ndodheshin përfituesit e shërbimit pasi ishin transferuar për të pushuar në Shtëpinë e Pushimit Velipojë. Nga intervista e realizuar me drejtuesen e institucionit trajtoheshin 4 fëmijë, sipas grupmoshës (1) fëmijë 7 vjeç, (2) fëmijë 6 vjeç dhe (1) fëmijë 5 vjeç.

Gjatë vitit 2016 Institucioni i Avokatit të Popullit ka realizuar dy inspektime në këtë institucion, inspektim i parë, i cili daton 26.05.2016 ku në këtë institucion trajtoheshin 19 fëmijë, 8 prej të cilëve ishin mbi moshën 6 vjeç dhe inspektimi i dytë, i cili daton në 21.12.2016 ku në këtë institucion trajtoheshin 4 fëmijë. Nga ky institucion për një periudhë kohore 6-të (gjashtë) muajore, janë larguar nga institucioni rreth 14 fëmijë. Ndërkohë që po për gjashtë muaj, periudha kohore Dhjetor 2016-Qershor 2017, ky institucion ka ofruar shërbime të përkujdesit social vetëm për katër fëmijë.

Në zbatim të Urdhërit Nr 88¹ dt 25.10.2011 të Kryeministrit janë përcaktuar organika me pozicionet e punës kategoritë përkatëse të punonjësve dhe numrin e tyre si me poshtë vijon për këtë institucion:

1 Drejtor

1 Përgjes i sektorit social (Punonjës Social)

5 Specialist (edukator)

8 Kujdestar

1 Përgjegjës i sektorit administrativ

2 guzhunier

18 punonjës gjithësej

Nga intervista e realizuar me drejtuesen e institucionit nga 5 specialistë (edukator) 1 specialist (edukator) me Urdhër të Shërbimit Social Shtetëror ushtron funksionin e psikologes, një specialist është vend vakant, në detyrë janë vetëm 3 specialistë (edukator). Nga 8 kujdestar, një vend kujdestar është vend vakant, në detyrë janë vetëm 7 kujdestar. Përgjegjësia e sektorit social është me leje lindjeje, e pazvendësuar. Organika e këtij institucioni për sektorin e kujdesit shëndetësor ishte e plotësuar me anë të një mjekeje me kohë të pjesshme.

Aktualisht në këtë institucion kemi të njëjtën situatë si në inspektimin e fundit të realizuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit në Dhjetor të 2016, ku janë të akomoduar 4 fëmijë, me një staf administrativ që kujdeset për ta, prej 16 personash dhe me një Vendim të Këshillit të Ministrave të ardhur në Shkurt 2017 për transferimin e këtij institucioni.

Institucioni i Avokatit të Popullit pyeti drejtuesen e institucioni lidhur me gjetjet e sipërcituara, e cila na informoi se Shtëpia e Fëmijës 3-6 vjeç Shkodër do të ndryshonte funksionin e saj në “Shtëpi Familje për fëmijët 16-18 vjeç” njoftuar me shkresë zyrtare nga Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror.

Nga intervista e realizuar me drejtuesen e institucionit, prezentë, dokumentacione të ardhura nga SHSSH ose të dërguara nga vetë institucioni, nuk kishte as një projekt të miratuar për transformimin e këtij institucioni, ku të përfshiheshin elementet kryesor të projektit (analizën e situatës, qëllimin objektivat, aktivitetet etj) përveç shkresës zyrtare ku bashkangjitur gjendej Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 105 datë 15.02.2017.

¹ Urdheri KM nr.252 date 1.11.2006; Urdhëri Nr.64 i Kryeministrit date 23.03.2010 ; Urdheri i Kryeministrit nr. 88, date 25.10.2011 ; Urdhëri nr. 150 I Kryeministrit datë 27.12.2012

Në shkresën zyrtare me Nr. 432/1 Port. datë 27.02.2017 Shërbimi Social Shtetëror i dërgon për njohje dhe zbatim Shtëpisë së Fëmijës 3-6 vjec, Shkodër Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 105 datë 15.02.2017 “Për një ndryshim në Vendimin Nr. 60, datë 01.02.2006 të Këshillit të Ministrave” Për miratimin e listës së inventarit të pronave shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Shërbimit Social Shtetëror” ku parashikohet se “Godina e Shtëpisë së Fëmijës 0-6 vjeç, Shkodër” me funksion qendër rezidenciale për fëmijët 0-6 vjeç zvendësohet me “Godina e Shtëpisë së Fëmijës 16-18 vjeç Shkodër” dhe funksioni për të cilin përdoret prona ndryshohet në “Shtëpi familje për fëmijët 16-18 vjeç” dhe është nën varësinë administrative të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

Institucioni i Avokatit të Popullit shpreh shqetësimin lidhur me administrimi dhe funksionimi e këtij institucioni ku:

1. institucioni nuk ka një licesnë,
2. VKM Nr. 105 datë 15.02.2017 parashikon ndryshimin e funksionit të këtij institucioni,
3. rregullorja dhe shërbimi është për fëmijët e grup-moshës 3-6 vjec
4. mungesa e një projekti të miratuar në këtë institucion për transformimin e këtij institucioni tashmë e bërë fakt më akt-ligjor të miratuar.
5. mungesa e platformës për funksionimin e këtij institucioni si “Shtëpi familje për fëmijët 16-18 vjeç”
6. Mungesës së Urdhërit të Ministrit për ngritjen e qendrës “Shtëpi familje për fëmijët 16-18 vjeç”

VKM Nr. 105 datë 15.02.2017 e cila ka hyrë në fuqi 27 Shkurt 2017 nuk e justifikon “periudhë tranzitore” të krijuar në këtë institucion për më shumë se gjashtë muaj, kur në institucion nuk ndodhet një paketë e plotë ligjore, bashkëlidhur më këtë VKM, për ndryshimin e funksionit të tij, ku ndryshon edhe grup-mosha e kategorisë përfutuese edhe tipologjia e shërbimit. Duke ju referuar periudhës së gjatë kohore të situatës tranzitore të krijuar në këtë institucion dhe punës përgatitore që duhet të kishte filluar për të zbatuar VKM Nr. 105/2017 si dhe në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjor që janë në fuqi, paketa ligjore **(i referohemi vetëm mos egzistencës së tyre në Shtëpinë e Fëmijës 3-6 vjeç Shkodër)** duhet të jetë e kompletuar në zbatim të legjislacionit në fuqi si më poshtë vijon:.

1. Në zbatim të nenit 3, të VKM Nr. 542, datë 27.7. 2005 “Për miratimin e Statutit të Shërbimit Social Shtetëror”, të ndryshuar, ku parashikohet se “*Shërbimi Social Shtetëror në nivel qendror dhe në nivel qarku ka detyrat si vijojnë “j) Mbledh, analizon dhe përpunon informacionin mbi ecurinë e shërbimeve shoqërore dhe raporton periodikisht në Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale. Harton raportin vjetor të vlerësimit të nevojave për shërbime shoqërore dhe kapaciteteve të shërbimeve publike dhe jopublike*” domosdoshmërisht duhet të jetë realizuar procesi i vlerësimit të nevojës për këtë shërbim (shtëpi familje për fëmijët e grup-moshës 16-18 vjeç) nëpërmjet mbledhjes e informacionit (të dhëna sasiore dhe cilësore, informacionin dhe faktet e duhura) të përfshira në analizën e situatës së projektit.
2. Në zbatim të gërmës c) të nenit 19, të VKM Nr. 542, datë 27.7. 2005 “Për miratimin e Statutit të Shërbimit Social Shtetëror”, të ndryshuar, ku thuhet se “*Drejtori i Përgjithshëm i SHSSH-së raporton në strukturën politikëbërëse për*

çështjet e ndihmës ekonomike dhe shërbimet sociale për:propozimet për përmirësime dhe ndryshime në legjislacion, si dhe për çdo nismë për rregullore organizative dhe funksionimi, në nivel qendror e vendor, projekte, studime e bashkëpunime në fushën e ndihmës ekonomike dhe të shërbimeve sociale, domosdoshmërisht duhet të ketë një projekt-propozim nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror drejtuar Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për transformimin e këtij institucioni të miratuar nga kjo e fundit.

3. Në zbatim të pikës 13) të Udhëzimit Nr. 6, datë 21.5.2014 “Për procedurat e sistemimit të fëmijëve në institucionet rezidenciale të përkujdesit shoqëror, publike dhe jopublike” ku thuhet se “*Institucionet rezidenciale të përkujdesit shoqëror, publik dhe jopublik, krahas dosjes së fëmijës mbajnë edhe një regjistër sipas modularit nr. 2*”, ku këto të dhëna cilësore shërbejnë për të vlerësuar/analizuar rast pas rasti cdo përfitues që trajtohej në këtë institucion dhe ata që do të trajtohen në të ardhmen. Ky studim i ka paraprirë dhe do ti paraprijë bashkëpunimit dhe bashkërendimit të punën me aktorë të tjerë në nivel vendor dhe qëndror për të mbështetur, për të përgatitur planin e të ardhmes së përfituesëve që trajtoheshin në këtë institucion dhe vlersimin te nevojave të përfituesëve që do të vendosen në këtë institucion në zbatim të *Vendimit e Këshillit të Ministrave nr. 659, datë 17.10.2005, “Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për fëmijët në institucionet rezidenciale”* duke vlerësuar interesin më të lartë të fëmijës. Element i rëndësishëm është edhe trajnimi i stafit për ti paragatitur, trajnuar më tipologjinë e re të shërbimit dhe statet e zhvillimit të kësaj grupmoshe, pjesë përbërëse e platformës.
4. Në zbatim **të nenit 8, të Ligjit nr.90/2012, “Per organizimin dhe funksionimin e administrates shtetërore”**, thuhet se “*Njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve:1. Njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve janë struktura administrative, nëpërmjet të cilave një ministri apo një institucion i varësisë kryen shërbime publike drejtpërdrejt për të tretët, në fushat e parashikuara shprehimisht me ligj. 2. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve krijohen dhe mbyllen me urdhër të ministrit përgjegjës përkatës, në përputhje me legjislacionin e posaçëm dhe pas konsultimit publik me përfaqësuesit e përfituesve të mundshëm të shërbimit, me qytetarët e interesuar, me njësitë e qeverisjes vendore dhe me aktorë të tjerë të interesit*”, domosdoshmërisht duhet të ketë dalë edhe urdhëri i Ministrit për ngritjen e qëndrës “Shtëpi familje për fëmijët 16-18 vjeç” ku në kuadër të analizave të lartë përmendura është parashikuar ri-organizimi i projekt-strukture dhe organikes perkatëse pasi është miratuar nga ministria e financave dhe me pas ne Departamenti i Administratës Publike.

Për sa më sipër, duke ju referuar vetëm monitorimit të realizuar në këtë institucion si dhe detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i akteve ligjore të sipërcituara, Institucioni i Avokatit të Popullit për efektivitetin e procesit, i cili lidhet me të drejtat e fëmijëve kërkon që Ministria e Mireqenies Sociale dhe Rinisë si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, paketën ligjore të përbërë nga projekti i miratuar, platforma dhe Urdhëri i Ministrit për transferimin e Shtëpisë së Fëmijës 3-6 vjec në Shtëpi Fëmije 16-18 vjec për funksionimin e saj si “Shtëpi familje për fëmijët 16-18 vjeç” t’i vihen në dispozicion për njohje dhe zbatim Shtëpisë së Fëmijës 3-6 vjec Shkodër, Bashkisë Shkodër dhe një kopje të tyre Institucioni të Avokatit të Popullit.

Në vlerësimin e Institucionit të Avokatit të Popullit, ky i fundit shpreh rezervat e tij për mospërputhje midis ligjeve të reja dhe atyre të mëparshme që trajtojnë çështjet e ofrimit të shërbimeve sociale për fëmijë në nevojë, kjo në zbatim nenit 52, **të ligjit Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë** i cili ka hyrë në fuqi në datën 22 Dhjetor 2016 thuhet se “1. Brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të gjitha qendrat rezidenciale dhe ofrimi i shërbimeve rezidenciale u transferohen njësisë të qeverisjes vendore” në vlerësimin e Institucionit të Avokatit të Popullit duke u bazuar në teknikën legjislative të hartimit të akteve ligjore dhe nëligjore kjo periudhë kohore konvergjon me kohën që duhet të dispozicion për të mundësuar vlerësimin e të gjithë elementëve kryesor të projekt-akteve të cilat do të mundësojnë transferimin e ketyre institucioneve të parashikuara në nenet 23,24,25 dhe 26 të ligjit Nr. 9000 datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, pra periudhën tranzitore që institucionet e përkujdesit social po kalojnë nën varësinë administrative të SHSSH, ky institucion do të transferohet Bashkisë Shkodër.

Ndërkohë, Bashkia Shkodër në zbatim të VKM nr 710 dt 24.10.2007 ka nën administrim Shtëpinë e Fëmijës 6-18 vjeç ku edhe në zbatim të *Vendimit Nr. 106 datë 15.02.2017 “Për një ndryshim në Vendimin Nr. 425 datë 27.06.2012 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve dhe dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucione rezidenciale, publike dhe jo-publike të përkujdesjes shoqërore”* ka detyrimin ligjor për të organizuar institucionet e përkujdesit social rezidencial për fëmijë sipas grupmoshave. Në këtë kontekst tipologjia e shërbimit rezidencial për grupmoshën 16-18 vjeç për Bashkinë Shkodër është një detyrim ligjor që duhet përmbushur.

Nga analiza ligjore e sipërcituar, pavarësisht afateve ligjore në fuqi por në respekt të hirariksë ligjore për përmbushur “parimin e autonomisë vendore” dhe “parimin e decentralizimit” në zbatim të Neni 13, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë ku në kuptimin e këtij përcaktimi “ofrimi i shërbimeve shoqërore bazohet në parimin e decentralizimit”, vlerësimin të nevojave nga vetë qeveria lokale dhe transferimit të këtyre shërbimeve në përputhje me nevojat e komunitetit, të vetë qeverisë lokale miratimi i VKM *Nr. 105 datë 15.02.2017 “Për një ndryshim në Vendimin Nr. 60, datë 01.02.2006 të Këshillit të Ministrave”* *Për miratimin e listës së inventarit të pronave shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Shërbimit Social Shtetëror*, rëndon vazhdimësinë e procesit të decentralizimit ku duhet të ketë bashkëpunim, bashkërendim ndërmjet qeverisë qendrore dhe lokale konkretisht Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë Shkodër.

Kjo e parashikuar edhe në gërmën e) të neni 36 **të ligjit Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë ku thuhet se:**“1. Bashkia ofron dhe administron shërbimet e kujdesit shoqëror brenda territorit të saj: e) duke bashkërenduar me Shërbimin Social Shtetëror shërbimet e nevojshme të kujdesit shoqëror”.

Për sa më sipër, Institucioni i Avokatit të Popullit kërkon që të sigurohet një bashkërendim efektiv midis këtyre organeve, ku konstaton me shqetësim, mungesën e koherencës midis institucioneve ekzistuese në ofrimin e shërbimeve të përkujdesit social të fëmijëve në nevojë dhe ngritjen e shërbimeve të orientuara drejt nevojave të pushtetit vendor, të cilët ndikojnë negativisht në koordinimin efektiv të programeve të mbrojtjes sociale dhe detyrimeve ligjore të parashikuara **në ligjin Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”**

Nga vëzhgimet përfundimtare të realizuara nga monitorimi i shërbimeve të përkujdesit social rezidencial për fëmijët në nevojë dhe nga analizat krahasuese, të thelluara të akteve ligjore egzistuese dhe ato të miratuara së fundmi në fushën e shërbimeve sociale për fëmijë, institucioni i Avokatit të Popullit, shpreh shqetësimin lidhur miratimin e akteve nënligjore të orientuara drejt organizimit të institucioneve sipas grupmoshave, çka rezulton lëvizjen e vazhdueshme të fëmijëve, prishjen e marrëdhënieve të tyre me stafin dhe ndarjen e fëmijët nga motrat/vëllezërit e tyre i cili bie ndesh me nenin 25 të Konvetës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

Në kuadër të procesit të decentralizimit, Institucioni i Avokati të Popullit vlerëson plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor si ligji Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji nr.9232 datë13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit”, i ndryshuar.

Më tej, Avokati i Popullit shpreh shqetësim lidhur me gjetjet e përmendura në raport lidhur me zbatimin efektiv të ligjeve që trajtojnë çështje të fëmijëve në nivele qendrore dhe ato bashkiake dhe vazhdimësinë e procesit të decentralizimit.

Në zbatim të nenit 21 të ligjit **Nr.8454, datë 4.2.1999, ”Për Avokatin e Popullit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar** “*paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”;

REKOMANDOJMË:

1. *Marrjen e masave për dërgimin e paketës ligjore të plotë ku në përbërjen e saj të jetë (projekti i miratuar, platforma dhe Urdhëri i Ministrit për transferimin e Shtëpisë së Fëmijës 3-6 vjec në Shtëpi Fëmije 16-18 vjec për funksionimin e saj si “Shtëpi familje për fëmijët 16-18 vjeç”) për njohje dhe zbatim Shtëpisë së Fëmijës 3-6 vjec Shkodër.(Ministria e Mireqenies Sociale dhe Rinisë si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror)*
2. *Marrjen e masave për dërgimin e paketës ligjore të plotë ku në përbërjen e saj të jetë (projekti i miratuar, platforma dhe Urdhëri i Ministrit për transferimin e Shtëpisë së Fëmijës 3-6 vjec në Shtëpi Fëmije 16-18 vjec për funksionimin e saj si “Shtëpi familje për fëmijët 16-18 vjeç”) për njohje, koordinim dhe bashkëpunim të shërbimeve të nevojshme sociale për fëmijët në nevojë (planit social) Bashkisë Shkodër.*
3. *Garantimin e bashkërendimit efektiv midis Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë Shkodër në koordinimin efektiv të shërbimeve social për fëmijë sipas detyrimeve ligjore të parashikuara në ligjin Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” në kuadër të koherencës midis institucioneve ekzistuese në ofrimin e shërbimeve të përkujdesit social të fëmijëve në nevojë që Bashkia Shkodër administron dhe Shtëpisë së fëmijës 3-6 vjec i cili administrohet nga SHSSH dhe në të ardhem do ti transferohen Bashkisë Shkodër. (Shërbimi Social Shtetëror)*
4. *Marrjen e masave për fillimin e punës përgatitore të vlersimit të nevojave për shërbime sociale për cdo bashki duke garantuar bashkëpunimin dhe bashkërendimin e punës në hartimin e planeve sociale të buxhetura për cdo bashki.*

5. *Përcaktimi i drejtime strategjike buxhetore për fëmijët në nevojë, të cilat duhet të jenë prioritetet kryesore në planin social të Bashkisë Shkodër duke u nisur edhe nga hapat e ndermarrë në zbatim të VKM Nr. 105 datë 15.02.2017 dhe Vendimit Nr. 106 datë 15.02.2017 “Për një ndryshim në Vendimin Nr. 425 datë 27.06.2012 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve dhe dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucione rezidenciale, publike dhe jo-publike të përkujdesjes shoqërore” në përputhje me analizën e realizuar në këtë raport. (Bashkia Shkodër)*

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”.Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin Tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe në vijimësinë e bashkëpunimit në funksion të garantimit të të drejtave të fëmijëve.

K O M I S I O N E R I

Ermir KAPEDANI